

## TERMAT E REFERENCËS

### Trajner për Akademinë e Menaxhimit Financiar për Organizatat e Shoqërisë Civile në Kosovë

#### 1. KONTEKSTI

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në bashkëpunim me Centar za promociju civilnog društva (CPCD) nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Center for Research and Policy Making (CRPM) nga Maqedonia e Veriut, po zbaton projektin ***SMART Balkans – Shoqëri Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor***, i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i rolit dhe ndikimit të organizatave të shoqërisë civile në rajon, përmes mbështetjes së nismave që promovojnë qeverisjen e mirë, sigurinë dhe stabilitetin. Në këtë kuadër, projekti ka krijuar Akademinë e Menaxhimit Financiar për Organizatat e Shoqërisë Civile, një program edukimi inovativ, praktik dhe pa pagesë, i cili synon të rrisë kapacitetet në menaxhimin financiar, përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe të donatorëve, si dhe të kontribuojë në qëndrueshmërinë afatgjatë të OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor.

Akademia do të zhvillohet paralelisht në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë, gjatë periudhës shtator–nëntor 2025. Programi do të përbëhet nga gjashte module tematike, me një ngarkesë të përgjithshme prej rreth 60 orësh trajnim. Trajnimet do të ofrohen nga trajnerë të licencuar dhe me përvojë, për një grup prej rreth 20 zyrtarësh apo menaxherësh financiarë nga OSHC-të në Kosovë.

#### 2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITSHME

Qëllimi kryesor i angazhimit të trajnerëve është të kontribuojnë në zhvillimin dhe zbatimin e një programi gjithëpërfshirës trajnimi, i cili synon rritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në fushën e menaxhimit financiar. Trajnerët do të ndihmojnë në hartimin e materialeve didaktike dhe në ofrimin e moduleve trajnuese që mbulojnë çështje kyçe të menaxhimit financiar në sektorin jo-fitimprurës.

#### Objektivat specifike përfshijnë:

- Hartimin e materialeve të trajnimit për secilin modul, duke përfshirë manuale, prezantime, ushtrime praktike dhe raste studimore;
- Lehtësimin e proceseve të të nxëniet përmes metodologjive interaktive dhe të orientuara drejt praktikës;
- Rritjen e njohurive dhe aftësive të pjesëmarrësve në fushat e buxhetimit, kontrollit të brendshëm, përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe të donatorëve, raportimit financiar dhe përgatitjes për auditim.

### **Rezultatet e pritshme:**

- Një kurrikulë e harmonizuar dhe materiale cilësore për çdo modul të programit;
- Realizimi me sukses i trajnimeve për një grup prej rreth 20 zyrtarësh financiarë të OSHC-ve në Kosovë;
- Rritje e dukshme e kapaciteteve praktike të pjesëmarrësve për të aplikuar njohuritë e përftuara në menaxhimin financiar të organizatës.

### **3. FOKUSI I THIRRJES / PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT**

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të projektit SMART Balkans, synon të angazhojë trajnerë/ekspertë për të kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e Akademisë së Menaxhimit Financiar për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në Kosovë.

Ky angazhim përfshin:

- Hartimin e materialeve didaktike dhe përmbajtjes së moduleve trajnuese, në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin për të rritur në Kosovë;
- Dhënien e trajnimeve për një grup prej rreth 20 zyrtarësh financiarë dhe menaxherësh të OSHC-ve në Kosovë;
- Lehtësimin e sesioneve praktike dhe mbështetjen e pjesëmarrësve gjatë gjithë programit.

Akademia do të zhvillohet përgjatë periudhës shtator – nëntor 2025, përmes gjashtë moduleve të specializuara dhe ndërvepruese, që adresojnë temat më të rëndësishme të menaxhimit financiar në sektorin jofitimprurës. Në total, programi do të përfshijë deri në 60 orë trajnimi dhe do të zhvillohet me prani fizike në Prishtinë.

### **Trajnerët mund të aplikojnë për një ose më shumë nga modulet e mëposhtme:**

1. Kuadri ligjor për funksionimin financiar të OSHC-ve
2. Hartimi i buxhetit dhe planifikimi financiar
3. Kontrolli i brendshëm dhe raportimi financiar
4. Menaxhimi financiar i projekteve dhe përputhshmëria me kërkesat e donatorëve
5. Tatimi, TVSH-ja dhe procedurat e prokurimit
6. Përgatitja për auditim dhe interpretimi i raporteve të auditit

### **Detyrat kryesore të trajnerit përfshijnë:**

- Hartimi i një metodologjie trajnimi për secilin modul, në bashkëpunim me ekipin e IDM;
- Zhvillimi i përmbajtjes përkatëse për modulin/modulet e zgjedhura, duke përfshirë:
  - Prezantime PowerPoint,
  - Manuale trajnimi dhe fletë pune,
  - Ushtrime praktike dhe analiza rastesh;
- Ofrimi i sesioneve të trajnimit për pjesëmarrësit e Akademisë, në përputhje me agjendën dhe orët e planifikuara;
- Përdorimi i metodologjive ndërvepruese dhe të bazuara në praktikë për të rritur përthithjen e njohurive dhe përfshirjen aktive të pjesëmarrësve;
- Monitorimi i progresit të pjesëmarrësve dhe ofrimi i mbështetjes individuale në rast nevojë;
- Hartimi i një raporti përfundimtar për modulin/modulet e mbuluara, duke përfshirë vlerësimin e zbatimit, sfidat e identifikuara dhe rekomandimet për përmirësim.

## **4. KUALIFIKIMET DHE AFTËSITË**

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme**

*(Përvoja, aftësitë dhe kompetencat përkatëse duhet të pasqyrohen në Shprehjen e Interesit):*

- Të kenë një diplomë universitare të nivelit Master në ekonomi, financë, kontabilitet, menaxhim ose në fusha të ngjashme;
- Të kenë së paku 5 vite përvojë profesionale në menaxhimin financiar të organizatave jofitimprurëse ose si ekspertë financiarë;



- Të kenë përvojë të mëparshme në zhvillimin dhe ofrimin e trajnimeve për të rritur, veçanërisht në fushën e financave dhe menaxhimit të OSHC-ve;
- Të zotërojnë aftësi të shkëlqyera në hartimin e materialeve didaktike dhe prezantimeve vizuale (PowerPoint, manuale, fletë pune);
- Të kenë njohuri dhe përvojë në përdorimin e metodologjive ndërvepruese dhe të orientuara drejt praktikës në procesin mësimor;
- Të kenë njohuri të thelluara mbi kuadrin ligjor financiar në Kosovë dhe mbi kërkesat tipike të donatorëve ndërkombëtarë;
- Të demonstrojnë aftësi të mira komunikuese dhe ndërpersonale, si dhe aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me ekipin.

## 5. PROCESI I PËRZGJEDHJES

Procesi i përzgjedhjes do të zhvillohet në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës dhe meritës. Të gjitha aplikimet do të vlerësohen nga një komision i ngritur nga IDM, në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- **Përvoja profesionale dhe përputhshmëria me fushën tematike të modulit(ve):** 60%
- **Propozimi financiar:** 40%

Vetëm kandidatët që paraqesin dokumentacionin e plotë do të konsiderohen të kualifikuar për vlerësim.

IDM rezervon të drejtën të kërkojë dokumentacion shtesë apo sqarime nga aplikantët gjatë procesit të vlerësimit, si dhe të mos përzgjedhë asnjë aplikant nëse vlerëson se nuk plotësohen standardet e kërkuara për cilësi.

Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen me email dhe do të ftohen për të realizuar një takim pranë zyrave të IDM përpara nënshkrimit të kontratës.

## 6. MBROJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat personale që janë dorëzuar për qëllimin e aplikimit në këtë thirrje (emrat, adresat e emailit, etj.) do të ruhen nga IDM me qëllim të përpunimit të aplikimeve dhe për t'i kontraktuar ata në lidhje me detyrat e mundshme që lidhen me thirrjen ose për t'i njoftuar për mundësitë e ardhshme të ngjashme me rolin specifik për të cilin aplikuan fillimisht. Të dhënat personale do të ruhen me kujdesin maksimal dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave.

Aplikantët mund të kërkojnë në çdo kohë të shohin të dhënat personale që ne mbajmë në lidhje me ta dhe të kërkojnë fshirjen e tyre.

## 7. KUSHTET E KONTRATËS

- **Kohëzgjatja:** Nga data e nënshkrimit të kontratës deri në dhjetor 2025.
- **Pagesa:** Do të kryhet 100% pas dorëzimit dhe pranimi të raportit përfundimtar të shërbimit, në përputhje me planin e punës të dakordësuar. Pagesa do të bëhet përmes transfertës bankare.

## 8. DORËZIMI I APLIKIMIT

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikimin e tyre në adresën e emailit:

**procurement@idmalbania.org**, me subjektin:

**“SMART Balkans – Trajner për Akademinë e Menaxhimit Financiar për OSHC”,  
brenda datës 5 shtator 2025.**

Aplikimi duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- **Aneksi 1:** Propozimi financiar i ofertuesit, në Euro. Çmimi duhet të përfshijë të gjitha kostot (përgatitje, trajnim, taksa dhe detyrime të tjera).
- **CV-ja e përditësuar.**
- **Letër interesi**, ku përshkruhet mënyra se si aplikanti plotëson kriteret, përvoja relevante, si dhe moduli/modulet për të cilat shpreh interes.
- **Kodi i Etikës i IDM**, i nënshkruar.

**Shënim:** Mosdorëzimi i ndonjërit prej dokumenteve të kërkuara, ose dorëzimi i dokumenteve të rreme apo të pasakta, do të çojë në skualifikim automatik.